



Data: 25.09.19 Ref.: 1785/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 76-të të mbajtur më 16.09.2019 mori këtë:

V E N D I M

- I. Akreditohen programet e studimit të Kolegjit "UBT" për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022:
 - Juridik, Kriminologji Kompjuterike dhe Forenzikë LLM, 60 ECTS, maksimum 25 student për vit akademik
 - Energjia Elektrike dhe Tregjet e Energjisë MSc, 120 ECTS, maksimum 50 student për vit akademik
- II. Refuzohet akreditimi i programit të studimit:
 - Laborant i Biokimisë Mjekësore BSc 180 ECTS
- III. Obligohet Kolegji UBT që deri me datë 1 tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Kolegji UBT ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit të cekura në dispozitiv të këtij vendimi. AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin UBT, me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional dhe të programeve të studimit. Vizita është realizuar me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Peter Parycek (Juridik, Kriminologji Kompjuterike dhe Forenzikë), Gabor Dombay (Energjia Elektrike dhe Tregjet e Energjisë), dhe Zdravko Lackovic (Laborant i Biokimisë Mjekësore).

Sa i përket programeve të studimit të cekura në dispozitivin I, ekspertët ndërkombëtarë kanë konstatuar se këto programe përmbushin substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar dhënien e akreditimit.

Sa i përket programit të studimit të cekur në dispozitivin II të këtij vendimi, eksperti ndërkombëtarë ka konstatuar se ky program përmbush pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht nuk ka rekomanduar akreditimin e tij. Për programin e studimit Laborant i Biokimisë Mjekësore BSc 180 ECTS, në kapitullin që lidhet me misionin, objektivat dhe administrimin, eksperti ndërkombëtarë ka konstatuar se ka kontradikta mes lëndëve dhe programit. Prandaj ka rekomanduar rishikim të dokumentacionit duke e vlerësuar përmbushjen e standardeve me vetëm 30%.

Sa i përket stafit akademik, eksperti thekson se nga i gjithë stafi akademik, një numër shumë i vogël prej tyre janë pjesë e databazave ndërkombëtare për hulumtim dhe shkencë. Ndarja e orëve dhe ngarkesës, rishikimi i syllabuseve dhe ofrimi i fushave të specializimit në formë tabelore duhet të prezantohen në vlerësimin tjetër. Si rezultat, eksperti ndërkombëtar e ka vlerësuar këtë fushë me 25% përmbushje të standardeve.

Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies është vlerësuar me vetëm 10% përmbushje të standardeve. Kjo si rezultat i mungesës së: 1. Një lënde cilësore e cila ka të bëjë me praktiken në laborator, 2. Syllabusi i etikës duhet të përfshijë Bio-etikën dhe Hulumtimin në Etikë, 3. Mungesa e lëndëve bazike në kurrikulë ejt.

Hulumtimi është një tjetër kapitull i vlerësuar vetëm pjesërisht. Kjo si rezultat i pjesëmarrjes jo të mjaftueshme të stafit akademik në hulumtim dhe shkencë. Për më tepër, eksperti potencon se abstraktet e publikuara nuk mund të cilësohen si publikime shkencore.